



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE  
SEKTORI I SPORTEVE

RELACION

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT  
FINANCIAR PËR SPORTISTËT DHE TRAJNERËT QË PËRFAQËSOJNË KLUBIN  
SHUMËSPORTËSH TEUTA NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE  
NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2026**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK  
KËTU**

Të nderuar Këshilltarë!

Në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, të ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020, si dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 15.12.2021, “Për kriteret dhe mënyrën e shpërblimit dhe trajtimit të sportistëve dhe trajnerëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë” të ndryshuar, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Komuniteteve Fetare, në funksion të garantimit të një zbatimi të drejtë, të unifikuar dhe ligjor të këtyre dispozitave, paraqet këtë relacion për propozim në Këshillin Bashkiak sa vijon:

Sportistë të nivelit të lartë, sipas nenit 3, pika 21 të Ligjit nr. 79/2017 të ndryshuar, citohet se ***“Sportistë të nivelit të lartë” janë persona që praktikojnë sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar sportin, duke marrë pjesë në veprimtari sportive dhe duke arritur rezultate të larta në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare***”.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, trajtimi ushqimor i sportistëve të nivelit të lartë rregullohet me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 789/2021, të ndryshuar.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Durrës, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, vlerëson të nevojshme miratimin e një skeme mbështetëse për sportet kolektive (volejboll dhe basketboll) që përfaqësojnë Klubin e Shumësporteve “Teuta” si edhe sportistët dhe trajnerët në sportet individuale të cilët kanë fituar vende të para, të dyta edhe të treta në nivel kombëtar.

Mbështetja e tyre përbën:

- një mekanizëm motivues për vazhdimësinë e performancës sportive;
- një instrument nxitës për përfshirjen e të rinjve në aktivitete sportive kolektive;
- një formë vlerësimi institucional për arritjet sportive;
- një kontribut në forcimin e imazhit të qytetit në nivel kombëtar.

Roli i trajnerëve është thelbësor në arritjen e këtyre rezultateve, ndaj përfshirja e tyre në këtë skemë mbështetëse konsiderohet e domosdoshme.

Klubi Shumësportësh “Teuta”, në cilësinë e njësisë shpenzuese të Bashkisë Durrës, përfaqëson strukturën zyrtare organizative për administrimin dhe zhvillimin e disiplinave sportive në territorin e Bashkisë. Për garantimin e transparencës, kontrollit administrativ dhe përdorimit të rregullt të fondeve publike, mbështetja do të aplikohet për sportistë dhe trajnerë të atashuar në shoqata sportive që kanë marrëveshje përfaqësimi me të.

### **I. Kriteret e përfitimit.**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026, sportistët dhe trajnerët e tyre do të trajtohen financiarisht, sipas skemës së miratuar në buxhet. Kriteret e përfitimit janë si në vijim.

1. Për sportet individuale propozohen këto kritere për trajtimin me mbështetje financiare:
  - Sportisti duhet të jetë mbi 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.
  - Sportisti duhet të jetë pjesë aktive e organizatës sportive që ka marrëveshje përfaqësimi me klubin shumësportësh Teuta dhe të ketë marrëveshje bashkëpunimi në fuqi me të.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Sportisti duhet të ketë marrëveshje përfaqësimi sportiv me Klubin e Shumësporteve “Teuta” Durrës, nëpërmjet organizatës sportive, pa krijuar marrëdhënie pune.
- Sportisti duhet të jetë i federuar aktivisht pranë federatës sportive përkatëse për sezonin sportiv në fuqi.
- Sportisti duhet të ketë arritur rezultate të renditura në kampionate kombëtare (vendet I–III), të certifikuara zyrtarisht.
- Sportisti duhet të përfaqësojë Klubin e Shumësporteve “Teuta” Durrës dhe qytetin e Durrësit në veprimtari sportive zyrtare.
- Sportisti duhet të jetë pjesë aktive e programit stërvitor, sipas planifikimit të miratuar nga organizata sportive dhe klubi.
- Sportisti nuk duhet të jetë i pezulluar dhe nuk duhet të ketë masa disiplinore në fuqi.
- Sportisti duhet të respektojë rregulloret sportive, etike dhe antidoping në fuqi.
- Sportisti nuk duhet të përfitojë trajtim ushqimor të dyfishtë nga struktura të tjera publike për të njëjtën periudhë.

**Dokumentacioni mbështetës:**

Organizata sportive përkatëse, për përfitim të trajtimit financiar për sportistët pretendent dhe/ose me perspektivë, duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë zyrtare e organizatës sportive, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor, për përfshirjen e sportistit në skemën e trajtimit financiar.
- Marrëveshje bashkëpunimi në fuqi ndërmjet organizatës sportive dhe Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës.
- Marrëveshje/Aneks përfaqësimi sportiv ndërmjet organizatës sportive dhe sportistit, ku përcaktohet përfaqësimi i qytetit dhe i klubit, pa krijuar marrëdhënie pune.
- Certifikatë federimi aktive e sportistit për sezonin sportiv në fuqi, e lëshuar nga federata sportive përkatëse.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Dokumentacion zyrtar i rezultateve sportive, që vërteton renditjen e sportistit në kampionatet kombëtare (vendet I–III), i certifikuar nga federata përkatëse.
- Kopje e dokumentit të identifikimit të sportistit
- Vërtetim nga federata ose organizata sportive që sportisti nuk është i pezulluar dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
- Deklaratë përgjegjësie nga organizata sportive, që garanton përmbushjen e kriterëve ligjore dhe sportive për sportistin e propozuar.
- Raport përmbledhës stërvitor dhe gare, që pasqyron angazhimin e sportistit gjatë periudhës përkatëse.
- Deklaratë e sportistit, ku pranon përfaqësimin e Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës dhe qytetit të Durrësit në veprimtari sportive zyrtare.

## 2. Kriteret për përfitimin e trajtimit financiar për sportet kolektive (ekipet)

Trajtimi financiar për sportet kolektive jepet jo individualisht, por në funksion të rezultatit sportiv të ekipit, i cili përfaqëson zyrtarisht qytetin e Durrësit dhe Klubin e Shumësporteve “Teuta” Durrës, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe përfaqësimit.

Trajtimi financiar konsiderohet mbështetje funksionale për përgatitjen sportive të ekipit dhe jo shpërblim individual.

### **Kushtet për përfitimin e trajtimit financiar nga ekipet**

Ekipet e sporteve kolektive përfitojnë trajtim financiar kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

- Ekipi përfaqëson një organizatë/shoqatë sportive që ka marrëveshje bashkëpunimi në fuqi me Klubin e Shumësporteve “Teuta” Durrës
- Ekipi ka marrëveshje përfaqësimi sportiv për qytetin e Durrësit dhe Klubin e Shumësporteve “Teuta” Durrës
- Ekipi merr pjesë në kampionatin kombëtar zyrtar të federatës përkatëse



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Ekipi ka arritur renditje nga vendi I deri në vendin II dhe pjesëmarrje në Play-off në kampionatin kombëtar të kategorisë më të lartë

Për t'u përfshirë në listën përfituese të ekipit, çdo sportist duhet:

- të jetë mbi 18 vjeç
- të jetë i federuar aktivisht për sezonin përkatës
- të ketë marrëveshje përfaqësimi sportiv me Klubin e Shumësporteve "Teuta" Durrës (përmes organizatës sportive)
- të ketë pjesëmarrje aktive në stërvitje dhe gara
- të mos jetë i pezulluar apo subjekt i masave disiplinore
- të mos përfitojë trajtim ushqimor të dyfishtë nga institucione të tjera publike

### **Dokumentacioni mbështetës për ekipet**

Organizata/shoqata sportive që propozon ekipin duhet të dorëzojë:

- Kërkesë zyrtare për përfshirjen e ekipit në skemën e trajtimit financiar
- Marrëveshje bashkëpunimi në fuqi me Klubin e Shumësporteve "Teuta" Durrës
- Marrëveshje/Aneks përfaqësimi sportiv për ekipin
- Vërtetim nga federata për pjesëmarrjen në kampionatin kombëtar
- Dokumentacion zyrtar të renditjes përfundimtare të ekipit
- Listë emërore të sportistëve aktivë të ekipit
- Certifikata federimi për secilin sportist
- Deklaratë përgjegjësie nga organizata sportive për administrimin korrekt të trajtimit ushqimor
- Raport përmbledhës stërvitor dhe gare i ekipit

### **Administrimi dhe kontrolli.**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Administrimi i trajtimit financiar për sportet kolektive kryhet në mënyrë të tillë që nuk është i detyrueshëm të jetë i barabartë për çdo sportist, por realizohet në funksion të angazhimit stërvitor, pjesëmarrjes në gara dhe nevojave reale të ekipit.

Për këtë qëllim:

Organizata/shoqata sportive përkatëse ka detyrimin që në fund të çdo muaji të paraqesë pranë Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës:

- listën emërore të sportistëve të ekipit që kanë marrë pjesë aktive në procesin stërvitor;
- listën përkatëse të federimit aktiv për sezonin sportiv në fuqi;
- një relacion përmbledhës mbi angazhimin stërvitor dhe sportiv të ekipit.
- Paralelisht, Specialisti i Sportit pranë Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës, i cili ka monitoruar nga afër sportet kolektive, harton një raport monitorimi, ku pasqyrohet:
  - pjesëmarrja reale e sportistëve në stërvitje dhe gara;
  - respektimi i programit stërvitor;
  - ecuria dhe disiplina sportive e ekipit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe raportit të specialistit të sportit, Klubi i Shumësporteve “Teuta” Durrës:

- kryen verifikimin përfundimtar;
- harton procesverbalin përkatës;
- dhe procedon me alokimin e fondeve për trajtimin financiar, në përputhje me fondin e miratuar.

Organizata/shoqata sportive përfituese ka detyrimin që:

- në fund të çdo muaji, ose në varësi të periudhës së alokimit të fondeve,
- të raportojë pranë Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës për përdorimin e fondeve të akorduara,



duke paraqitur:

- procesverbalin justifikues të shpërndarjes së trajtimit financiar;
- dokumentacionin financiar përkatës;
- si dhe pagesat bankare që vërtetojnë shpërndarjen e fondeve.

Kjo mënyrë administrimi garanton një proces transparent, të verifikueshëm dhe të kontrollueshëm, duke siguruar që fondet publike të përdoren vetëm për qëllime sportive dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.

### **3. Kriteret për përfitimin e trajtimit financiar për trajnerët**

Roli i trajnerëve është thelbësor në arritjen e këtyre rezultateve, ndaj përfshirja e tyre në këtë skemë mbështetëse konsiderohet e domosdoshme. Në mbështetje të nenit 3 pika 30 dhe nenit 28 të Ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin” të ndryshuar, lidhen me trajnerët .

- Trajneri të jetë i pajisur me Licencën e Trajneri
- Të ketë kualifikim profesional të njohur nga Federata përkatëse;
- Të jetë i licencuar sipas kategorisë së sportit që drejton.
- Të ketë marrëveshje të vlefshme me Organizaten/shoqatën sportive që përfaqëson Klubin e Shumësporteve “Teuta”
- Të mos ketë masa disiplinore aktive
- nuk duhet të jetë i pezulluar nga federata;
- nuk duhet të ketë masa për sjellje antisportive;
- nuk duhet të jetë nën procedime për shkelje të etikës sportive.
- Trajneri duhet të jetë i pranishëm në garat zyrtare të sportistit ku :

Dhe duhet të dokumentojë:

- protokolle gare,
- raporte për pjesëmarrjen dhe drejtimin teknik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Dokumentacioni mbështetës:**

Të dorëzohet dokumentacion të vlefshëm që dëshmon përmbushjen e kriterëve, si:

- Certifikata e Licencës si Trajner (e lëshuar nga federata ose institucioni sportiv).
- Vërtetim nga federata që është trajneri zyrtar i sportistit apo ekipit
- Marrëveshje të vlefshme me Organizaten/shoqaten sportive që përfaqëson Klubin e Shumësporteve “Teuta”
- Raport mujor i procesit stërvitor.
- Evidenca nga garat (protokolle, lista pjesëmarrjeje, autorizime).
- Deklaratë personale ku trajneri konfirmon:
  - që nuk ka masa disiplinore;
  - që nuk merr përfitime të dyfishta;
  - që është përgjegjës për përgatitjen e sportistit sportist i nivelit të lartë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak, pranë Klubit të Shumësporteve “Teuta” Durrës, në bashkëpunim me Sektorin e Sporteve pranë Bashkisë Durrës, ngrihet Komisioni i Posaçëm i Verifikimit, i cili shqyrton dhe verifikon dokumentacionin përkatës. Pas verifikimit, Komisioni harton procesverbalin e konstatimit.

Në bazë të këtij procesverbali, Drejtori përkatës nxjerr urdhrin për miratimin e trajtimit financiar sipas listave përfundimtare. Zbatimi financiar kryhet nga Klubi, me monitorim nga Bashkia Durrës, duke garantuar një proces transparent dhe të kontrollueshëm.

**DREJTOR**  
**Migena Muhaj**